



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railëay Regulatory Authority



Në bazë të nenit 38, paragrafi 2, neni 94, neni 104 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	NR.PROT. BR.PROT. NR.PROT.
01	90
NUMRI I FAQEVE BRUJ STRANA NR OF PAGES	DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:
20	28/03/2018
PRISHTINË / A	

Rregullore Nr. 02/2018 për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me Kërkesat për Marrjen e Certifikatës së Sigurisë Hekurudhore

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i metodës së përbashkët të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e certifikatës së sigurisë, siç përshkruhet në nenin 94, nenin 104 (3) të Ligjit 04/L-063 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, nenin 6 (3) (b) si dhe nenin 10 të Direktivës 2004/49 / EC.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë operatorët hekurudhor të cilët operojnë ligjërisht brenda territorit të Republikë së Kosovës.

Neni 3

Definicionet

“Metodat e Përbashkët të Sigurisë” nënkupton: procedurën dhe kriteret për vlerësimin e aplikacioneve të bëra nga ndërmarrjet hekurudhore për certifikatë të sigurisë, si dhe parimet për mbikëqyrjen e përputhjes me kërkesat e Direktivës 2004/49 / EC pasi që organi nacional i sigurisë ka dhënë certifikatën, siç përcaktohet në Shtojcën IV të kësaj rregullore.

Për qëllimet e kësaj Rregullore, do të zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:

"mbikëqyrja" nënkupton masat e aplikuara nga organi i sigurisë për të mbikëqyruar performancën e sigurisë, pasi që ky organ të ketë dhënë një certifikatë të sigurisë.

“**Organi Nacional i Sigurisë**”, nënkupton Departamentin e Sigurisë brenda Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Neni 4

Formulari i aplikimi për autorizim të sigurisë

Për të aplikuar për certifikatë të sigurisë, aplikanti duhet të përdor formularin zyrtar të aplikimit të ARH-së, i cili mund të gjendet edhe në faqen tonë të internetit www.arh-ks.org.

Neni 5

Procedurat për vlerësimin e aplikacioneve

5.1. Organi i Sigurisë duhet tu përgjigjet me përpikëri kërkesave dhe aplikimeve dhe të bënë komunikimin e informacionit sipas kërkesave të tyre pa ndonjë vonesë. Organi i Sigurisë duhet të miratoj të gjitha vendimet e veta brenda afateve të përcaktuara ligjore.

5.2. Gjatë shqyrtimit të kërkesave për certifikatat e sigurisë të Pjesës A dhe B, të paraqitura pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, organi i sigurisë zbaton procedurën e përcaktuar në Shtojcën I të kësaj Rregullore për vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e Ligjit mbi Hekurudhat si

